

VENDIM
Nr. 67, datë 6.9.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME DROPULL

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Dropull sh.a., për licencim për herë të parë, Komisioni Kombëtar Rregullator, konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dropull sh.a. ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për herë të parë, me shkresën me nr. 39 prot., të datës 13.6.2018, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dropull sh.a. është themeluar në datën 21.12.2017, si shoqëri aksionare me një nivel administrimi në pronësi të Bashkisë Dropull, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura". Kjo shoqëri është regjistruar në QKB në datën 16.2.2018, me NUIS: L82616601E;

- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti i ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dropull, si dhe akti i miratimit higjieno-sanitar, si dhe pagesa për licencim për dy kategoritë e kërkuara. Dosja u plotësua në datën 27.7.2018.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Dropull sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për licencim për herë të parë, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës-Kanalizime Dropull sh.a., me:
Drejtues ligjor: Alqi Kazazi;
Drejtues teknik: Gaqe Meçi.
2. Operatori Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar, në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Dropull.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani